Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

AGJENCIA E SHTETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

Nr.	Emertimi	Njësia	Sasia për 4 Vite	Çmimi për njësi Leke pa TVSH	Vlera pa TVSH	AFATI 4 VITE
A	Dietat për të rritur					
1	Dieta Nr.1	dieta	275,364			
2	Dieta Nr 2 (Hidrike A)	dieta	1,764			
3	Dieta Nr 2 (Hidrike B-1)	dieta	852			
4	Dieta Nr 2 (Hidrike B-2)	dieta	528			
5	Dieta Nr.3	dieta	37,868			
6	Dieta Nr.4	dieta	37,152			
7	Dieta Nr.5	dieta	53,504			

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

8	Dieta Nr.6	dieta	112			
9	Dieta Nr.7	dieta	16,656			
10	Dieta 8	dieta	192			
11	Dieta Nr. 9	dieta	1908			
12	Dieta Nr.10	dieta	216			
13	Dieta Nr.11	dieta	52			
14	Dieta Nr.12	dieta	224,716			
15	Dieta Nr.13	dieta	56,116			
16	Dieta Nr.14	dieta	306,964			
17	Dieta Nr.15	dieta	37,888			
B	Dietat per femijet					
18	Dieta Nr.1 A Normale	dieta	7,484			
19	Dieta Nr.1 B Normale	dieta	6,140			
20	Dieta Nr.1 C Normale	dieta	6,356			
21	Dieta Nr.1 D Normale	dieta	7880			
22	Dieta Nr.2 A Normale	dieta	41,212			
23	Dieta Nr.2 B Normale	dieta	21,936			
24	Dieta Nr.2 C Normale	dieta	31,956			
25	Dieta Nr.3 A	dieta	24			
26	Dieta Nr.3 B	dieta	468			
27	Dieta Nr.4 A	dieta	1,020			
28	Dieta Nr.4 B	dieta	844			
29	Dieta Nr.5 A	dieta	4,396			
30	Dieta Nr.5 B	dieta	14,676			
31	Dieta Nr. 6 A	dieta	820			
32	Dieta Nr. 6 B	dieta	1,692			

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

33	Dieta Nr. 7	dieta	4			
34	Dieta Nr. 8	dieta	148			
35	Dieta Nr. 9 A	dieta	700			
36	Dieta Nr. 9 B	dieta	1924			
37	Dieta Nr.10	dieta	696			
Fondi i Marrëveshjes Kuadër: 1,122,292,924 (një miliard e njëqind e njëzet e dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e katër) Lekë (pa TVSH)				_____		
Ose 10,595,666 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjete e pese mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjete e gjashtë) Euro.				_____		
Çmimi Neto pa TVSH				_____		
TVSH (%)				_____		
Çmimi total me TVSH:				_____		
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit				_____		
Nënshkrimi				_____		
Vula				_____		
Datë _____				_____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Më poshtë do të gjeni tabelat për secilën dietë që do të përdoren për pacientët e QSUT, me normativat për secilin përbërës të dietës, si dhe inventarin që duhet të ketë kontraktuesi, që do të jenë pjesë integrale e kontratës.

Dieta për të rritur / QSUNT

Dieta Nr.1 (Dieta normale)

≈ 2 773 k kal (prot 100gr, lipide 77gr, glucide 420gr)

Nr.	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht	ml	300
2	Sheqer	gr	15
3	Buke	gr	250
4	Oriz/makarona	gr	150
5	Zarzavate	gr	500
6	Vaj	ml	30
7	Mish	gr	150
8	Fruta	gr	300
9	Djathe,gjize	gr	80
10	Gjalp	gr	10

Perdoret: Per te semure me aparat tretes normal

Dieta Nr 2 (Hidrike A)

102 k kal (prot 3.5, lipide 9.8, glucide 0 gr)

Nr.	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Leng mishi / Zarzavate	gr	1000

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

2	Djathe i grire	gr	100
---	----------------	----	-----

Dieta Nr 2 (Hidrike B1)

400kkal, (prot. 0gr,lipide 0gr,glucide 100g

Nr	Asortimenti	Nj. M.	Sasia
1	Leng frutash	Gr	1000
2	Sheqer	Gr	100

Dieta Nr 2 (Hidrike B2)

400 kkal(prot. 0gr,lipide 0gr, glucide 100 gr)

Nr.	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Uje	ml	1000
2	Sheqer	gr	100

Dieta Nr.3 (Dieta e semundjeve infektive)

2613 k kal (prot.80 gr, lip.61, gluc.436 gr)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Sheqer	gr	20
3	Recel/prevede	gr	100
4	Oris ose makarona	gr	130
5	Buke	gr	160
6	Vaj	ml	30
7	Gjalpe	gr	5
8	Mish	gr	140

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

9	Patate	gr	200
10	Zarzavate	gr	200
11	Djathe pa kipe	gr	100
12	Fruta	gr	400

Perdorim ne hepatitet virale ,salmoneloze,enterkolite te pa vertetuara,bruceloze etj.

Dieta Nr.4

2129 k kal (prot 70 gr, lip.95.3 gr, gluc.248.6gr)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Sheqer	gr	60
2	Mjell orizi	gr	60
3	Vaj	ml	30
4	Mish	gr	60
5	Biskota	gr	20
6	Krem qumeshti (pana)	gr	50
7	Xelatin frutash (recel)	gr	50
8	Veze	koker	1
9	Fruta	gr	500

Perdorim ne hepatitet virale ,salmoneloze,enterkolite te pa vertetuara,bruceloze etj.

Dieta Nr.5

1616 kkal (prot.80 gr. yndyrna 12gr. gluc.297gr.)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	700

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

2	Sheqer	gr	60
3	Biskota	gr	100
4	Vaj	ml	30
5	Oriz	gr	50
6	Mish	gr	120
7	Patate	gr	200
8	Fruta	gr	400
9	Djathe	ml	30
10	Veze	koker	1

Perdoret ne fazen postoperatore tek te semuret me pamundesi ose ne mungese per te pertypur e gelltitur,ne semundjet psikike,anoreksi nervore,gjendje fibrile te zgjatur shoqeruar me anoreksi,semundjet e fytit e ezofagut ,stomakut.Ushqimet e forta grimcohen e perpunohen.

Dieta Nr.6

2 098 k cal (prot.90gr. yndyrna lip.50gr. gluc.322gr.)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Sheqer	gr	15
3	Oris/makarona	gr	120
4	Vaj	ml	10
5	Gjalpe	gr	5
6	Mish	gr	160
7	Patate	gr	200
8	Zarzavate	gr	200
9	Buke	gr	120

10	Djathe	gr	100
----	--------	----	-----

Dieta Nr.7

1532 k kal (prot.82gr. lip.16gr. gluc.265 gr.)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	1500
2	Sheqer	gr	20
3	Buke	gr	60
4	Oriz	gr	100
5	Gjalpe	gr	20
6	Veze	koke rr	1
7	Patate	gr	250
8	Djath i njome	gr	70

Perdorete ne disa forma te dispepsive,ne gastritet,gastroduodenit,ne klecistoptite pas interventeve kirurgjikale ne stomak,abdomen,koleciste,hemihiatale.

Dieta 8

Hipokalorike 1857 kkal (prot.80gr. lip.57gr. gluc.256gr.)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	400
2	Sheqer	gr	10
3	Zaravate	gr	350
4	Oriz/malcarona	gr	100
5	Vaj	gr	15
6	Mish	gr	130

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

7	Fruta	gr	500
8	Buke	gr	120
9	Djathe	gr	70

Dieta 8/1 Normokalorike

≈2709 k kal (prot.98 gr ,lip.73 gr, gluc.415gr)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	500
2	Sheqer	gr	20
3	Zarzavate	gr	500
4	Oriz/makarona	gr	150
5	Vaj	gr	20
6	Mish	gr	150
7	Fruta	gr	500
8	Buke	gr	120
9	Djathe	gr	120
10	Ose veze	koker	2

Perdoret ne
 gastritet hiperacide
 ne ulcerat gastrite
 e duodenale ne
 fazen aktive pa
 hemoragji, ne
 fazen aktive si dhe
 cikatrizimet.

Dieta Nr. 9

2079 k kal (prot.70gr. lip.63, gluc.308gr)

AGJENCIA E SHTETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Caj,leng frutash, caj, kamomil	ml	200
2	Sheqer	gr	10
3	Buke	gr	140
4	Oriz	gr	130
5	Gjalpe	gr	30
6	Mish	gr	100
7	Karota,patate	gr	400
8	Fruta	gr	200
9	Djathe	gr	100

Perdoret per gastroenterite,colite,enerokolite

Dieta Nr.10 (pa gluten)

2764 kkal (prot. 100 gr. lip.78.5gr. gluc. 385.5 gr)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	550
2	Sheqer	gr	20
3	Djathe	gr	50
4	Veze/	gr	1
5	Gjalpe	gr	15
6	Vaj	gr	15
7	Zarzavate	gr	550
8	Mish	gr	200
9	Oriz	gr	150
10	Fruta	gr	400

11	Buke misri	gr	200
----	------------	----	-----

Dieta Nr.II

2207 k kal (prot.21 gr. lip.75gr. gluc.362gr)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Leng frutash.caj	ml	400
2	Sheqer	gr	40
3	Recel,marmalate	gr	100
4	Oriz ,makarona/ pa proteina	gr	150
5	Veze	gr	1
6	Fruta	gr	400
7	Zarzavate	gr	200
8	Djathe	gr	30

Dieta Nr.12

(2292 k kal (prot.88gr. lip.92gr. gluc.278gr.)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	600
2	Buke	gr	150
3	Zarzavate	gr	500
4	Veze	koker	1
5	Djathe	gr	50
6	Gjalpe	gr	20
7	Oris	gr	100
8	Mish	gr	100

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

9	Vaj	ml	25
10	Fruta	gr	500

Dieta Nr.13 (Dieta normokalorike-shume e varfer ne Na)

2 280 k kal (prot.90gr. lip.64gr. gluc.336gr.)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Mish	gr	100
3	Veze	koke rr	1
4	Gjize	gr	50
5	Vaj	ml	30
6	Gjalpe	gr	10
7	Zarzavate	gr	400
8	Fruta	gr	350
9	Buke pa kripe	gr	160
10	Oriz	gr	130

Perdoret ne semundjet ap.kardiovaskulare dhe urinare ne fazen e kompensimit ne semundje n e melcise ,pankreasit e surenaleve.Perdorimi i kripes nuk duhet bere i lire kur nisin shenjat e dekompozimit.Kur azotemia e kratinemia ,kur produktet si:mishi,qumeshti dhe nenproduktet nderpritin, ne diet shtohen frutat deri ne 150gr.

Dieta Nr.14 (Onkologe) Hiperkalorike ,hiperproteinike,hiperglucidike e pasur me Ca e Fe.

3 000 k kal (prot,122gr. Yndyrnat 108gr. Gluc.385gr.)

AGJENCIA E SHTETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	600
2	Mish	gr	200
3	Vaj	ml	30
4	Gjalpe	gr	15
5	Djadhe/gjize	gr	100
6	Veze	koke rr	1
7	Sheqer	gr	30
8	Oris	gr	110
9	Zarzavate	gr	500
10	Fruta	gr	400
11	Buke	gr	300

Kjo diete peredoret ne anemi,kaheksi,TBC,semundje malinje,otopedi,plastike,rehabilitim,semundje psikike.

Dieta 15 (Dieta per femije deri ne 14 vjec)

1803 K kal (78 g Prot. 55 g yndyna , 249 g gluc)

Nr	Asortimenti	Nj. m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	400
2	Buke	gr	210
3	Oriz / makarona	ml	50
4	Zarzavate	gr	200
5	vaj	gr	20
6	Mish	gr	80
7	Frutar	gr	200
8	Djathe	gr	50

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

9	Sheqer	gr	20
10	Recel	gr	50

Perdoret per femije 1-14 vjec te shtruar sipas specialisteve ORL

DIETAT PEDIATRIKE / QSUNT

Nr.1.A. Per femijet 1-4 muaj (481.5 kkal,prot 13.5 gr, yndyrna 22.5 gr,gluk 56.25 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht (formule standarde 1)	ml	750

1.B. Per femijet 4-6 muaj (481.5 kkal,prot 13.5 gr, yndyrna22.5 gr,gluk 56.25 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht (formule satandarde 1)	ml	750
2	Oriz (miell)	gr	5
3	Sheqer	gr	10
4	Perime (te stines)	gr	150

1.C. Per femijet 6-8 muaj (481.5 kkal,prot 13.5 gr, yndyrna 22.5 gr,gluk 56.25 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	330
2	Miell	gr	10
3	Perime (te stines)	gr	250
4	Vaj	gr	35
5	Mish (i fresket, vici)	gr	50
6	Djathe (lope, i bardhe)	gr	15
7	Sheqer	gr	10
8	Fruta (te stines)	gr	100

1.D. Per femijet 8-12 muaj (481.5 kkal,prot 13.5 gr, yndyrna 22.5 gr,gluk 56.25 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	gr	100
2	Mish (i fresket, vici)	gr	40
3	Djathe (lope, i bardhe)	gr	20
4	Fruta (te stines)	gr	100
5	Veze (2 here/jave)	cp	0.29

Dieta Nr.2 A- Diete normale (per femije 1-3 vjec) 1400k.kal (Prot.43.4gr yndyrna 52.2gr, gluk.189 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	rnl	300
2	Perime (te stines)	gr	380
3	Mish (i fresket, vici)	gr	40
4	Gjalpe (lope)	gr	20
5	Sheqer	gr	35
6	Vaj (ulliri)	ml	10

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

7	Buke (gruri)	gr	60
8	Fruta (te stines)	gr	300
9	Veze	cp	1

Dieta Nr.2.B. normale per femije nga 3-6 vjec)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	250
2	Recel	gr	30
3	Perime (te stines)	gr	500
4	Mish (i fresket,vici)	gr	60
5	Sheqer	gr	35
6	Vaj (ulliri)	ml	10
7	Djathe (lope, i bardhe)	gr	60
8	Buke (gruri)	gr	190
9	Veze	cp	1
10	Fruta (te stines)	gr	200

 2390 k.kal (prot.75gr, yndyr.70gr,
gluk. 365gr.

Dieta Nr.2.C. per femije 6-14 vjec

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	400
2	Buke (gruri)	gr	100
3	Perime (te stines)	gr	250
4	Vaj (ulliri)	ml	35
5	Mish (i fresket, vici)	gr	100
6	Fruta (te stines)	gr	300
7	Djathe (lope, i bardhe)	gr	70
8	Sheqer	gr	40
9	Makarona	gr	85
10	Biskota	gr	40

 Dieta Nr.3 A per semundje virale, hepatite, tifo, per grup moshen 1-3 vjec
1213 k.kal (prot.38.5gr, yndyr.50.2gr, gluk. 152gr.

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	330
2	Oriz	gr	20
3	Perime (te stines)	gr	430
4	Djathe (lope, i bardhe)	gr	20
5	Recel	gr	20
6	Vaj (ulliri)	ml	10
7	Sheqer	gr	35
8	Buke (gruri)	gr	60
9	Fruta (te stines)	gr	150

 1858 k.kal (prot.66gr, ynd.66gr,
gluk.250gr.

Dieta Nr.3.B. per femije 3-14 vjec

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	500
2	Perime (te stines)	gr	200

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

3	Vaj (ulliri)	ml	35
4	Mish (i fresket, vici)	gr	100
5	Fruta (te stines)	gr	350
6	Djathe (lope, i bardhe)	gr	30
7	Sheqer	gr	40
8	Buke	gr	120
9	Oriz	gr	50

Dieta Nr.4.A.

 E homogjenizuar, normokalorike me sonde, per femije 1-3 vjec
 1549 k.kal (prot.49.6gr, yndyr.83gr, gluk. 151 gr.)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	rml	200
3	Sheqer	gr	55
4	Oriz (miell)	gr	40
5	Perime (te stines)(per leng)	ml	300
6	Mish (i fresket, vici)	gr	50
7	Djathe (lope, i bardhe)	gr	20
8	Vaj (ulliri)	ml	45
9	Fruta te stines	gr	200
10	Veze	cp	1

Dieta nr. 4.B.

 E lengeshme, normokalorike, me sonde, (per femije 3-14 vjec),
 1854 k.kal (prot.66gr, yndyr.70gr, gluk.240gr.),

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	500
2	Perime (te stines)	gr	220
3	Vaj (ulliri)	ml	30
4	Mish (i fresket, vici)	gr	100
5	Fruta (te stines)	gr	300
6	Djathe (lope, i bardhe)	gr	30
7	Sheqer	gr	40
8	Biskota	gr	70

Dieta nr.5.A.

 Per semundjet hematologjike, onkologjike, tuberkuloz, imunodeficence
 per femije 1-3 vjec, hiperkalorike, hiperproteinike 1738 k.kal/ditë
 (prot.63g, yndy.54 gr, gluk.250gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	300
2	Oriz	gr	15
3	Recel	gr	30
5	Perime (te stines)	ml	400
6	Mish (i fresket, vici)	gr	40
7	Djathe (lope, i bardhe)	gr	75
8	Gjalpe (lope)	gr	10
9	Sheqer	gr	50
10	Vaj (ulliri)	ml	10

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

11	Buke (gruri)	gr	60
12	Veze	cp	1
13	Fruta (te stines)	gr	300

Dieta nr.5.B.

Per semundjet hematologjike, onkologjike, tuberkuloz, imunodeficence), 2383 k.kal/dite, (prot.90gr, yndyr.79gr, gluk.328gr.). Për fëmijë 3-14 vjeç, hiperkalorike

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	500
2	Buke (gruri, e zeze)	gr	250
3	Perime (te stines)	gr	300
4	Vaj (ulliri)	ml	20
5	Mish (i fresket, vici)	gr	150
6	Fruta (te stines)	gr	350
7	Djathe (lope, i bardhe)	gr	70
8	Sheqer	gr	30
9	Veze	cp	1
10	Oriz	gr	105

Dieta Nr.6.A.

Per semundjet renale, akute e kronike dhe cirozat hepatike. Për fëmijë 1-3 vjeç
1782 k.kal/dite, (prot.53gr, yndyr.58gr, gluk.262gr.)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	120
2	Recel	gr	30
3	Makarona	gr	85
4	Perime (te stines)	ml	300
5	Sheqer	gr	50
6	Gjalpe (lope)	gr	25
7	Buke (gruri)	gr	60
8	Fruta (te stines)	gr	200

Dieta Nr.6.B.

Per semundjet renale, akute e kronike, dhe cirozat hepatike,
Per femijë 3-14 vjec, (normokalorike, hipoproteinike, hyposode),
1766 k.kal/dite. (prot.20gr, yndyr. I4gr, gluk.390gr.)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Leng frutash	ml	400
2	Perime (te stines)	gr	200
3	Recel	gr	100
4	Veze	cp	1
5	Fruta (te stines)	gr	400
6	Djathe (Lope, i bardhe)	gr	30
7	Sheqer	gr	30
8	Oriz	gr	100

Dieta Nr.7

Per sindromin nefrotik, hepatite kronike te dekompensuara, cirozat hepatike

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

Per femije 6-14 vjec, (hiperproteinike, hipolipide, hiposodike),
1780 k.kal/dite, (prot.80gr, yndyr.60gr, gluk.230gr.),

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml/gr	300
2	Buke (gruri)	gr	130
3	Perime (te stines)	gr	400
4	Vaj (ulliri)	ml	20
5	Mish (i fresket, vici)	gr	80
6	Fruta (te stines)	gr	350
7	Gjalpe (lope)	gr	10
8	Oriz	gr	100
9	Veze	cp	1

Dieta Nr.8,
1796 k.kal/dite. (prot.67gr, yndyr.60gr. ,
gluk.247gr.),

Pa gluten, per femije 3- 14 vjec

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml/gr	450
2	Buke (misri)	gr	150
3	Perime (te stines)	gr	350
4	Vaj (ulliri)	ml	30
5	Fruta (te stines)	gr	350
6	Gjalpe (lope)	gr	10
7	Oriz	gr	100
8	Mish	gr	80
9	Djathe (lope, i bardhe)	gr	50
10	Sheqer	gr	20
11	Veze	cp	1

Dieta Nr.9.A.

2192 k.kal/dite. (prot.80 gr, yndyr. 88gr,
gluk.270gr.)

Per femije diabetike (per femije 3-14 vjec),

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml/gr	500
2	Buke (gruri, e zezë)	gr	130
3	Perime (te stines)	gr	400
4	Vaj (ulliri)	ml	20
5	Mish (i fresket, vici)	gr	100
6	Fruta (të stines)"	gr	400
7	Gjalpe	gr	20
8	Oriz	gr	80
9	Veze	cp	1

Dieta Nr.9.B.

2397 k.kal/dite, (prot.96gr, yndyr.77gr,
gluk.330gr.)

Per femije diabetike (per femije 3-14 vjec),

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	450
2	Perime (te stines)	gr	400
3	Mish(i fresket,vici)	gr	100
4	Fruta(stines)	gr	400
5	Oriz	gr	80
6	Buke (gruri,zeze)	gr	130
7	Veze	cp	1
8	Gjalp (lope)	gr	30

Dieta Nr.10

E lengshme per repartet ditore

Per femije 1-14 vjec

650 k.kal (prot 16gr, yndyre 11gr, gluk 122 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	500
2	Sheqer	gr	100

Materiale e mjete profesionale që duhet të ketë O.E. në dispozicion pas shpalljes së fituesit ditën e lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Nr.	Emërtimi	Nësia	Sasia e kërkuara
1	Tenxhere e madhe profesionale	Copë	minimumi 6
2	Banak shërbimi ngrohës / ftohës	Copë	minimumi 3
3	Tigan i madh profesional	Copë	minimumi 6
4	Dhoma frigoriferike	Copë	minimumi 3
5	Frigorifer freskues/ngrirës	Copë	minimumi 4
6	Frulatorë dhe ose shtrydhëse frutash	Copë	minimumi 2
7	Furrë profesionale me gaz / me korent	Copë	minimumi 4
8	Makine grirese mishi	Copë	minimumi 2
9	Makinë grirëse zarzavatesh	Copë	minimumi 2
10	Karrela shërbimi në kuzhinë	Copë	minimumi 8
11	Karrike mense	Copë	minimumi 40
12	Karroca termike shërbimi ushqimi (banjomari)	Copë	minimumi 20
13	Karroca shërbimi per mbledhje tabaka shërbimi	Copë	minimumi 50

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

14	Lavamane inox	Copë	minimumi 30
15	Peshore të vogla	Copë	Minimumi 30
16	Qeruese patatesh	Copë	Minimumi 2
17	Sobë me vatra gaz /korent	Copë	minimumi 2
18	Tavolina shërbim ngrenie mense	Copë	minimumi 20
19	Tavolina pune inox	Copë	minimumi 20
20	Brumatriçe	Copë	minimumi 1
21	Lavastovilje profesionale kuzhine	Copë	minimumi 2

Material i imët:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia e kërkuar
1	Gota uji jo plastike, jo qelqi	Copë	Min 1000
5	Luge inox tavoline	Copë	Min 1000
6	Pirunj inox tavoline	Copë	Min 1000
7	Pjata jo plastike, jo qelqi	Copë	Min 1000
8	Tabaka vetsherbimi jo plastike, jo qelqi	Copë	Min 1000
9	Tasa jo plastike, jo qelqi	Copë	Min 1000
10	Tava inox	Copë	Min 300
11	Thika inox tavoline	Copë	Min 1000

Gjithashtu, grupi i punës hartoi specifikimet teknike duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe duke marrë parasysh eksperiencat e mëparshme që Qendra Spitalore “Nënë Tereza” ka me procedurë të ngjashme.

Specifikimet teknike për shërbimin me objekt “Për ofrimin e shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët e hospitalizuar në shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

1. Kontraktuesi duhet të ketë licensë profesionale për ushtrim aktiviteti me objekt përpunim dhe shpërndarje ushqimi, catering, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licënsimit.

2. QSUT-ja do të vendosë në përdorim ambjentin e kuzhinës qendrore, ku sipërmarrësi **mund** të ushtrojë aktivitetin e shërbimit të kateringut, në rast se OE do të shprehë interesin për të përdorur ambjente që disponon QSUT. Për mjedisin që do të merren në përdorim, sipërmarrësi duhet të paguajë qeranë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto mjedise nuk mund të tjetërsohen. Kur janë të nevojshme të bëhen përshtatje, për shkaqe teknologjike, merret miratimi me shkrim nga QSUT-ja.
3. Operatori ekonomik përgatit ushqimin në mënyrë të përqëndruar në kuzhinë çdo ditë në bazë të numrit të të shtruarve bazuar sipas përcaktimeve të dietave të kartelës së pacientit, vënë nga mjeku kurues përkatës dhe të konfirmuar nga dietologu, si dhe të personelit mjekësor që është në shërbim 24 orë.
4. Në të gjitha rastet dhe për të gjitha vaktet, llogaritja e racioneve sipas dietave bëhet nga specialisti i Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, çdo ditë.
5. Çdo ditë, kryeinfermieri në bashkëpunim me shefin e shërbimit, harton forcën ditore totale për pacientët e shërbimit dhe brenda orës 13:00 e dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.
6. Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore sipas racioneve apo dietave duke shtuar dhe numrin e personelit mjekësor (mjekë) që trajtohet me ushqim gjatë shërbimit 24 orësh.
7. Kontraktuesi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin mjekësor që është në shërbim 24 orësh në vendin që do të caktohet për këtë qëllim. Mensa, do të jetë në funksion vetëm të stafit të QSUT, dhe jo për persona që vijnë nga jashta kundrejt pagesës në mensë, apo instiucione të tjera që OE mund të ketë kontrata të ngjashme.
8. Makineritë, pajisjet dhe materiali i imët dhe ndihmës si për kuzhinën dhe për pavionet do të sigurohen nga kontraktuesi, i cili do të përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.
9. Kontraktuesi duhet të disponojë minimalisht tre mjete transporti frigoriferike, të përshtatshme për transportin e produkteve ushqimore, të cilat plotësojnë kushtet higjieno sanitare.
10. Automjetet do të jenë të pajisura me certifikatë higjieno sanitare të lëshuara nga organet kompetente Shqiptare.
11. Pasqyra përmbledhëse e përgatitur nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, i dorëzohet përgjegjësit të kuzhinës së operatorit ekonomik çdo ditë brenda orës 14:00, e cila shërben si porosi për ditën e nesërme.
12. Transporti i ushqimit të përgatitur në kuzhinën kryesore deri në pavion dhe më tej tek pacienti, realizohet nga operatori ekonomik me enë të posaçme (termuse) inoxi të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasië që ofrohet si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit dhe temperaturës. Ushqimet dorëzohen nga kontraktuesi në minikuzhinat e pavioneve në varësi të kontraktuesit duke shpërndarë ushqimin deri tek shtrati i pacientit, për ta tërhequr më pas, pas një ore.

13. Të gjitha termuset dhe enët që transportohet ushqimi duhet të jenë detyrimisht me material inoxi dhe mbyllje hermetike për të ruajtur produktet nga agjentet atmosferike.
14. Në rast se OE fitues, shpreh interesin dhe ka dëshirë të marrë për përdorim ambientet aktuale të kuzhinës qendrore për ushtrimin e veprimtarisë së tij, duhet të lidhë kontrata me UKT dhe OSHEE dhe të paguajë vetë mbi konsumin e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm çdo muaj referuar vlerave që lexohen në matësat që do të jenë në objekt.
15. Ushqimet duhet të përgatiten në racione individuale sipas dietave të përcaktuara nga mjeku kurues.
16. Këto racione duhet të përgatiten në minikuzhina dhe të shpërndahen me karrela të lëvizshme me kate, të vendosen në tabaka të veçanta sipas dietave për çdo pacient.
17. Ky ushqim duhet të serviret detyrimisht i mbuluar me qese plasmasi (rulon), për të ruajtur higjenën kulinare., në rastet kur nuk mund të konsumohet nga pacienti në orarin e caktuar, për arsye të ndryshme.
18. Ushqimet e përgatitura në racione individuale sipas porosisë së një dite më parë, të shpërndahen në pavione, si më poshtë:
 - **3 herë në ditë për pacientët adultë:**
 - Mëngjesi, 07:00-08:00;
 - Dreka, 12:00-13.00;
 - Darka, 19:00-20:00;
 - **5 herë në ditë për infantët (Pediatriinë);**
 - Mëngjesi, 07:00-08:00;
 - Vakti ndërmjetëm 1, 10:00
 - Dreka, 12:00-13.00;
 - Vakti i ndërmjetëm 2, 15:00
 - Darka, 18:00-19:00;
19. Në pavionet që përcakton AK do vendoset një minikuzhinë që është në përdorim të sipërmarrësit. Kjo minikuzhinë përdoret për të mbajtur inventarin e të gjitha llojeve të enëve që nevojiten për shpërndarjen e ushqimit deri tek pacienti.
20. Baza materiale për shpërndarjen e ushqimit për secilin pacient si dhe për minikuzhinat sigurohet nga sipërmarrësi.
21. Sipërmarrësi përdor minikuzhinën vetëm për shpërndarjen e ushqimit tek pacienti dhe jo për larje apo dezinfektim të mjeteve që përdoren për shërbimin e ushqimit deri tek pacienti.
22. Sipërmarrësi në minikuzhina konsumon ujë dhe energji elektrike për të cilat duhet të bëjë pagesat përkatëse sipas matësave që vetë operatori ekonomik do t'i vendosë brenda këtyre ambienteve.
23. Enët që përdoren për shpërndarjen e ushqimit tek pacienti duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin. Ato nuk duhet të jenë absolutisht plastike.

24. Ushqimet si kosi, gjalp, reçeli, etj., duhet të jenë detyrimisht të paketuara me ambalazh njëpërdorimsh.
25. Sipërmarrësi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin që është në shërbim 24 orësh.
26. Materiali njëpërdorimsh dhe materialet larëse mbulohen nga kontraktuesi.
27. Vetëm personeli mjekësor me shërbim 24 orë konsumon ushqimin në mensën e kuzhinës, këtu bën përjashtim personeli që është në shërbim urgjence dhe reanimacion, të cilët e marrin pranë vendit të punës, të pakeluar sipas standardeve.
28. Ngarkesa e personelit që kryen shpërndarjen e ushqimit në pavione është e ndryshme nga një pavion në tjetrin, sipas specifikave: (dhe sa herë kërkohet shtim stafi nga A.K)
 - Numri i shtretërve;
 - Veçoria e të sëmurit; - të sëmurë rëndë apo me problem të shëndetit mendor.
29. Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me konfirmim të AK dhe duhet të respektojnë oraret e shpërndarjes së ushqimit tek pacientët.
30. Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtrimit të profesionit të tij.
31. Punonjësit duhet të sillen me edukatë dhe kortezi si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të QSUT.
32. Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.
33. Sigurimi i të gjitha artikujve ushqimore do të jetë sipas kalorive përkatëse të miratuara.
34. Llojshmëria e ushqimit do të jetë sipas sezonit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara sipas programit të menisë së përgatitur në baze të dietave dhe kalorive të konfirmuara nga mjeku dietolog.
35. Dietat e veçanta që nuk përfshihen në dietat e parashikuara, por që mund të kërkohen nga A.K., do të aprovohen nga mjeku dietolog dhe kurues, dhe vlerësohen nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
36. Kontraktuesi do të sigurojë ushqim të sigurtë, të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet.
37. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e kuzhinës dhe minikuzhinave, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.
38. Ushqimet do të nënshtrohen kontrollit të analizave, biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standartet e të ushqyerit.
39. Kontraktuesi duhet të sigurojë ambiente me temperaturën e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve në kuzhinë.
40. Kontraktuesi merr përsipër evadimin e mbeturinave të prodhuara gjatë procesit të përgatitjes së ushqimit. Ndërsa, mbeturinat pas konsumit të ushqimit do të

largohen nga vete operatori, dhe nuk do të depozitohen në asnjë pikë grumbullimi të QSUT.

41. Në pavionet e të sëmurëve infektivë, shpërndarja e ushqimit do të kryhet me material njëpërdorimsh.
42. Ushqimet që janë gati për konsum do të ndahen në porcione dhe do të shpërndahen në pavione, në oraret e caktuara.
43. Përgatitja e pjatave, pirunjve, lugëve e tabakave, si dhe pastrimi i mëtejshëm është detyrë e personelit të Kontraktuesit.
44. Mjeku roje në QSUT do të trajtohet me dietën onkologje numër 14.

Për Operatorin Ekonomik – Detyrat që duhet të zbatohen nga O.E.

1-Regjistrim i përditësuar i monitorimeve të HACCP për matjen e shkallës së higjenes së pajisjeve, ambjenteve, personelit dhe pikave kritike nga Përgjegjësit e kuzhinës (P.K)

2-Monitorimi i proceseve të punës të kryera nga personeli të cilat duhet të jenë konform praktikave të mira të higjenes dhe të realizohen me pajisjet e duhura.

3-Kontrolli viziv dhe bakteriologjik në hallka të ndryshme të procesit teknologjik (pikave kritike dhe pikave të kontrollit) duke filluar nga lënda e parë, magazinimi, gatimi, ambllazhimi, transporti dhe deri tek analizat laboratorike vjetore.

4-Kontrolli nga ana e P.K për higjenzimin dhe dezinfektimin të mjedisit, mjeteve të punës dhe transportit me metoda kimike duke përdorur detergjente të përshtatshme të çertifikuar. Gjithashtu kontrolli i ndërhyrjes me metoda fizike për të ç'rrënjësuar mbetjet kimike dhe organike në ambjentet e punës.

5-Raportim i përditshem për infektimin e ambjenteve nga agjentët biologjikë tek DS dhe P.HACCP.

6-Vleresim i emergjencave dhe/ose shkallës së infektimit të strukturës në rast prezence të agjenteve biologjik dhe marrja e vendimit për ndërhyrje të menjëhershme me preparate nga ana e P.HACCP.

7-Ndërhyrje për realizimin e Dezinfektimit dhe/ose deratizimit përkatesisht, të kryhet nga shoqëri të çertifikuara në shërbimin DDD.

8-Mirëmbajtja e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm nga dëmtimet fizike. Pastrimi dhe lyerja periodike e këtyre ambjenteve.

9-Bashkëpunimi me organet e kontrollit të subjekteve jashte kompanisë: Instituti Higjenes, Instituti i sigurisë ushqimore dhe veterinare, Autoriteti i Kontrollit Ushqimor.

10-Kontrolli periodik shëndetësor i personelit për gjendjen shëndetësore të tyre (librezat shëndetësore). Mos pranimiti në punë i punonjësve pa librezë shëndetësore dhe raport të komisionit mjeko ligjor KML.

Marrja e mostrave për analizat laboratorike

1.Për qëllim të kontrollit zyrtar të ushqimeve merren mostra të materialeve të papërpunuara të përbërësve, shtesave teknologjike dhe të substancave të tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimeve, ushqimeve gjysëm të gatshme, ushqimeve të gatshme, materialeve në kontakt me ushqimet, përfshirë substancat që përdoren për pastrimin dhe mirëmbajtjen në biznesin ushqimor.

2.Proçedurat e marrjes së mostrave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë.

3.Kontraktuesi do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të ushqimit të gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Kontraktuesi, është i detyruar të ruajë në rafte të veçanta në mjediset e kuzhinës kampionet e ushqimit të gatuar që do të shpërndahet për 24 orë. Ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

Normat E Sjelljes Për Një Përgatitje/Përpunim Të Sigurtë Të Produkteve Ushqimore.

Për të parandaluar sëmundjet e transmetuara nga produktet ushqimore dhe për të garantuar cilësi dhe siguri të produkteve, është e nevojshme që operatori në përpunimin e produkteve ushqimore, të ndjekë, norma sjelljeje të sakta, që Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përmbledhur në DEKALOGUN (10 pikat) në vazhdim, përshtatur nevojave lokale:

- Larja e duarve vazhdimisht
- Mbajtja e një higjene personale të përpiktë
- Ndërgjegjësimi për gjendjen shendetesore
- Mbrojtja e ushqimeve nga insektet, brejtësit dhe kafshëve të tjera.
- Mbajtja pastër e të gjitha sipërfaqeve
- Respektimi i temperaturave të konservimit
- Të evitohet kontakti i ushqimeve krudo me ato të pjekura
- Pjekja dhe ngrohja e ushqimeve
- Përdorimi i ujit të pijshëm
- Respektimi i planit të vetëkontrollit

Çdo sipërmarrje ushqimore nga më e vogla tek më e madhja duhet të ketë një plan vetëkontrolli në të cilën përshkruhen rreziqet në lidhje me ushqimet dhe masat parandaluese relative, që kompania vë në zbatim për të parandaluar ose mbajtur në kontroll rreziqe të tilla: të paturit dijeni dhe zbatimi i procedurave të përshtatura, është një detyrë dhe obligim për secilin operator.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes kuadër do të jetë 4 vjet për arsye se shërbimi i ushqimit është shërbim tejet i rëndësishëm për Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’, i cili ka ndikim të drejtëpërdrejt edhe në terapinë e pacientit. Duke pasur një rol kyç, ky shërbim ka natyrë të përsëritur, dhe kërkon që operatori ekonomik të kryejë një investim afatgjatë dhe cilësor në mënyrë që të mos ketë asnjë mungesë në shërbimet mjekësore. Gjithashtu, duke vlerësuar edhe kohën e nevojshme që ligji parashikon për kryerjen e procedurave të

prokurimit, arrijmë në përfundimin se një marrëveshje kuadër afatgjatë do ndihmojë në një shërbim sa më cilësor të **ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes për pacientët e hospitalizuar në shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare Nene Tereza.**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Emertimi	Njësia	Sasia	Afati 4 Vite
A		Dietat për të rritur		
1	Dieta Nr.1	dieta	275,364	
2	Dieta Nr 2 (Hidrike A)	dieta	1,764	
3	Dieta Nr 2 (Hidrike B-1)	dieta	852	

4	Dieta Nr 2 (Hidrike B-2)	dieta	528	
5	Dieta Nr.3	dieta	37,868	
6	Dieta Nr.4	dieta	37,152	
7	Dieta Nr.5	dieta	53,504	
8	Dieta Nr.6	dieta	112	
9	Dieta Nr.7	dieta	16,656	
10	Dieta 8	dieta	192	
11	Dieta Nr. 9	dieta	1908	
12	Dieta Nr.10	dieta	216	
13	Dieta Nr.11	dieta	52	
14	Dieta Nr.12	dieta	224,716	
15	Dieta Nr.13	dieta	56,116	
16	Dieta Nr.14	dieta	306,964	
17	Dieta Nr.15	dieta	37,888	
B		Dietat per femijet		
18	Dieta Nr.1 A Normale	dieta	7,484	
19	Dieta Nr.1 B Normale	dieta	6,140	
20	Dieta Nr.1 C Normale	dieta	6,356	
21	Dieta Nr.1 D Normale	dieta	7880	
22	Dieta Nr.2 A Normale	dieta	41,212	
23	Dieta Nr.2 B Normale	dieta	21,936	
24	Dieta Nr.2 C Normale	dieta	31,956	
25	Dieta Nr.3 A	dieta	24	
26	Dieta Nr.3 B	dieta	468	
27	Dieta Nr.4 A	dieta	1,020	
28	Dieta Nr.4 B	dieta	844	

AGJENCIA E SHITËTËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

29	Dieta Nr.5 A	dieta	4,396	
30	Dieta Nr.5 B	dieta	14,676	
31	Dieta Nr. 6 A	dieta	820	
32	Dieta Nr. 6 B	dieta	1,692	
33	Dieta Nr. 7	dieta	4	
34	Dieta Nr. 8	dieta	148	
35	Dieta Nr. 9 A	dieta	700	
36	Dieta Nr. 9 B	dieta	1924	
37	Dieta Nr.10	dieta	696	

Afatet e ekzekutimit: Do të jetë nga momenti i nënshkrimit te kontratës/kontratave, sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 48 (dyzete e tete) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: ofrim i shërbimit sa më cilësor të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes për pacientët e hospitalizuar në shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare Nene Tereza.

Detyrat: Përgatitja e ushqimit sipas specifikimeve teknike sipas dietave të përcaktuara nga AK,

Shpërndarja: Sipas nevojave të autoritetit kontraktor në pavionet përkatëse.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore.

Shënim 1.1:

